



PJESMARRJA E GRAVE NË PUNËN E PARTIVE POLITIKE

Bella Pallankë, Bujanoc, Dimitrovgrad, Pirot, Preshevë



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Centar za razvoj građanskog društva



Center for civil society development

Ana Jovanović

Ivan Tasić

PJESMARRJA E GRAVE NË PUNËN E PARTIVE POLITIKE

Bella Pallankë, Bujanoc, Dimitrovgrad, Pirot, Preshevë

Botues

Qendra për zhvillimin e shoqërisë qytetare PROTECTA

Për botuesin

Millan Stefanoviq

Koordinator i hulumtimit

Millan Mijoviq

Lektor dhe korrektor

PROTECTA tim

Tirazhi

300 (në gjuhën Serbe, Bullgare dhe Shqipe)

Botimin e këtij hulumtimi e ndihmoi

Agjensioni Zviceran për bashkëpunim dhe zhvillim - SDC.

Qendra për zhvillimin e shoqërisë qytetare PROTECTA

Obrenoviçeva bb, TPC Kalça BI/43, 18000 Nish

Tel/faks: 018/522-788; 018/514-360

E-mail: centar@protecta.org.rs

<http://www.protecta.org.rs>

PJESMARRJA E GRAVE NË PUNËN E PARTIVE POLITIKE

Bella Pallankë, Bujanoc, Dimitrovgrad, Pirot, Preshevë

Nish

Shtator viti 2012.

Ky hulumtim u ngrit si pjese e aktiviteteve projektuese të Qendrës për zhvillimin e shoqërisë qytetare PROTECTA, në kuadër të projektit "Barazisë - Pjesëmarrja e grave në punën e partive politike", i mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim - SDC.

Qëllimi i projektit është promovimi i demokracisë dhe institucioneve demokratike, nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve të partive politike për pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë në nivel lokal.

PËRMBAJTJA

PËRMBLEDHJE	5
Summary	6
HYRJE	7
KONTEKSTI	9
REZULTATET E HULUMTIMIT	11
REKOMANDIMET	32

PËRMBLEDHJE

Hulumtimi mbi pjesëmarrjen e grave në partitë politike është kryer në komunat e Bella Pallankës, Bujanocit, Dimitrovgradit, Pirotit dhe Preshevës në korrik-gusht të vitit 2012. Në hulumtim kanë marrë pjesë 23 organizata politike të madhësive të ndryshme, profile dhe parime programore. Sipas këtij sondazhi, politika lokale në këto komuna krijohet nga meshkujt. Ata dominojnë pozicionet prej të cilave sillen vendimet, si në nivelin partiak poashtu dhe në të gjitha nivelet e pushtetit vendor. Sa është pozicioni më i lartë, atëherë dihet se në atë pozicion është mashkull. Përveç kësaj, konteksti lokal dhe bindjet politike nuk kanë pothuajse asnjë ndikim në pozitën e grave në partitë politike apo për pozicionimin e tyre në skenën politike lokale. Pas gjitha këtyre të dhënave, studimi tregoi se çështje të tilla si barazia gjinore, përfshirja e grave në aktivitetet e partive politike dhe fuqizimi i grave në politikë nuk kanë vend në agjendën politike të partive që veprojnë në Bella Pallankë, Bujanoc, Dimitrovgrad, Piroti dhe Preshevë.

SUMMARY

Research about the participation of women in the work of political parties was carried out in five municipalities, Bela Palanka, Bujanovac, Dimitrovgrad, Pirot and Preševo, starting in July and ending in August of 2012. Twenty three political organizations participated, organizations that greatly vary in size, profile and party principles.

According to the results of the research, the local politics of said municipalities are created by men. Men dominate the decision-making positions on party level, but also on the level of the entire local government. Higher ranking positions are almost exclusively occupied by men. Whereat, local context and political affiliation have almost no influence on the position of women in political parties, or on their position on the local political stage.

In spite of all that, the research has also shown that topics such as gender equality, inclusion of women in the work of political parties or empowerment of women for political participation have not found their place in the political agenda of the parties active in Bela Palanka, Dimitrovgrad, Pirot, Bujanovac and Preševo.

HYRJE

E drejta e veprimit politik të të gjithë qytetarëve pavarësisht nga individualiteti apo dallimi i tyre, është një nga karakteristikat themelore të demokracisë moderne. Sot, qytetaret kanë të drejtë të zgjedhin ose të zgjidhen dhe lirinë e pjesëmarrjes së tyre aktive në jetën politike dhe shoqërore të komunitetit janë të garantuara nga një seri e akteve më të larta juridike ndërkombëtare dhe vendore. Megjithatë, zbatimi i të drejtave dhe lirive të shpallura shpesh hasin në një sërë pengesash, që për të kapërcyer nevojitet një veprim më i gjerë shoqërorë. Në këtë punë, partitë politike sigurisht që kanë një rol shumë të rëndësishëm. Në fakt, me rregullat e brendshme të shkruara dhe të pashkruara, partitë politike hapin derën për një pjesëmarrje më të madhe ose më të vogël politike të grave. Mënyra me të cilën partitë e inkurajojnë pjesëmarrjen e grave në punën e saj, shkallën në të cilën ato janë në vendet ku merren vendimet dhe krijohet politika partiake dhe angazhimi i partive për çështjen e barazisë gjinore, na tregojnë qëndrimin që partitë e kanë për pjesëmarrjen e grave në sferën tradicionalisht mashkullore. Qëndrimet ndaj grave në politikë dhe niveli i ndjeshmërisë gjinore që zbatohet brenda partive shumë shpesh është edhe qëndrim i cili reflektohet në tërë jetën politike.

Hulumtimi që është para jush merret me pjesëmarrjen politike të grave, përkatësisht pjesëmarrjen e tyre në organizatat politike në komunat e Bella Pallankës, Bujanocit, Dimitrovgradit, Pirotit dhe Preshevës. Hulumtimi nuk ka pasur për qëllim vlerësimin e praktikave të partive të caktuara, por është menduar kryesisht për të ofruar një pasqyrë të gjerë të mundësive që gratë të marrin pjesë në jetën politike dhe të përparojnë në shkallën e pushtetit politik. Hulumtimi është kryer në dy faza dhe ka përfshirë gjithsejtë 23 organizata politike, përkatësisht 17 parti politike dhe 6 grupe të qytetarëve. Të gjitha partitë dhe grupet qytetare që morën pjesë në studim janë të përfaqësuara në kuvendet e komunave lokale të caktuara. Theksi është në organizatat politike që ka peshë në komunitetet e tyre lokale dhe mund të ndikojnë në krijimin e politikave lokale. Faza e parë e hulumtimit nënkuptonte plotësimin e pyetësorit nga përfaqësues të organizatave politike. Pyetjet në pyetësor ishte të ndara në tri pjesë: (1) pjesën me të cilën është përcaktuar marrëdhënia në mes burrave dhe grave në anëtarësimin e përgjithshëm dhe aktiv në organizatat politike, (2) që është marrë me numrin e grave në pozita udhëheqëse në parti, ose numrin e

grave në parti që ushtrojnë funksione publike, dhe (3) e cila është dashur të përcaktojë qëndrimin e partive në të ashtuquajturat çështjet e grave si dhe mënyrat me të cilat partitë merren me këtë çështje. Faza e dytë e hulumtimit përbëhej nga grupet e fokusit, nga një në secilën prej komunave të synuara, në të cilat kanë marrë pjesë aktiviste të partive lokale. Nëpërmjet fokus grupeve janë shqyrtuar qëndrimet e mundësive që gratë të merren me politikë në mjedisin lokal, pozita e grave brenda partive, aftësia e tyre për të ndikuar në vendimet që sillen përkatësisht mundësitë e grave për të përparuar në shkallën e pushtetit brenda partisë.

Pjesëmarrja e organizatave politike që të marrin pjesë në studim ishte i kënaqshëm, megjithatë, ka pasur edhe disa probleme të cilat pjesërisht e kanë zvogëluar shtrirjen e kërkimit. Dy probleme do ti kishim veçuar. Së pari, shumica e partive nuk kanë një bazë të dhënash elektronike të anëtarësimit, kështu që një pjesë e përgjigjeve të pyetësorit në të vërtetë janë vlerësim i personit ose persona të cilët plotësuan pyetësorin. Një problem tjetër është struktura organizative e grupit të qytetarëve, përkatësisht mungesa e strukturës organizative formale të këtyre pjesëmarrësve në studim, kështu që një pjesë e përgjigjeve të pyetësorit, në rastin e tyre nuk ishin relevante¹.

Publikimi *Pjesëmarrja e grave në punën e partive politike* ndahet në tri pjesë - *Konteksti*; *Hulumtimi*; dhe *Sugjerimet*. *Konteksti* përmban kronikë të shkurtër mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe nevojën për numër më të madh të grave në vendet në të cilat sillen vendimet dhe krijohet politika. *Hulumtimi* paraqet rezultatet mbi pjesëmarrjen e grave në punën e partive politike në secilën nga pesë komunat e caktuara, si dhe përfundimet në tërësi deri ku kanë arritur gjatë analizimit të të dhënave të mbledhura. Në fund, në *Sugjerime* është ofruar një sërë masash për kyçe më të madhe të grave në punën e organizatave politike (parti, lëvizje, grupe qytetare). Këto masa nuk janë recetë dhe garancion për sukses, por gjithsesi do të ndihmonin organizatave politike të përparojnë punën e tyre dhe të pozicionohen më mirë në skenën politike.

Besojmë se ky hulumtim do ti nxisë edhe disa hulumtues të ardhshëm që të merren me pjesëmarrjen e grave në jetën politike dhe rolin e partive politike në atë proces.

¹ Pjesë e pyetësorit kishin të bënin me strukturën e brendshme të partive politike, veçanërisht numri dhe lloji i komisioneve përkatëse, dmth shkalla e pjesëmarrjes së grave në punën e tyre. Grupet e qytetarëve të cilët morën pjesë në këtë studim nuk janë të organizuara në këtë mënyrë, përkatësisht ato nuk e kanë të përcaktuar strukturën organizative në drejtim të ndarjes së resorëve dhe këshillave, kështu që ky grup pyetjesh për ta nuk ishte përkatës.

KONTEKSTI

Fillet e lëvizjes feministe në fund të shekullit XIX dhe në fillim të shekullit XX janë ngushtë të lidhura me participimin politik të grave. Duke njohur politikën si sferë e cila mbërthen botën, aktivistet e asaj periudhe – sifrazhetkat, kanë luftuar për të drejtat e grave që të zgjedhin përfaqësueset e veta dhe që të zgjidhen vetë. Lufta shumë-dekadore ka dhënë frute dhe deri nga mesi i shekullit XX gratë në tërë Evropën dhe botën, fitojnë të drejtën e votës dhe fillojnë të angazhohen politikisht. Natyrisht, ndryshimet ligjore nuk garantojnë ndryshime të menjëhershme në shoqëri, kurse një nga çështjet e rregullimit shoqërorë, e cila ndryshon shumë ngadalë, është ekzistimi i ndarjes në punë 'meshkujsh' dhe 'grash', përkatësisht sferat. Shikuar në tërësi punët që janë të lidhura me sferën private, kulturore apo për përkujdesjen mbi të tjerët mendohen si punë 'grash', deri sa punët lidhur me sferën publike, fizikisht të rënda, por edhe punët lidhur me sjelljen e vendimeve kategorizohen si punë 'burrash'. Këso ndarje nuk janë të mprehta, dhe varen nga faktorë të shumtë – nga shkalla e emancipimit të shoqërisë së gjithmbarshme, shkalla e emancipimit të gruas, situatës ekonomike.

Pavarësisht nga ata faktorë pjesëmarrja e grave në sferat tradicionale 'burrash' do të jetë më e madhe apo më e vogël (vlen edhe e kundërta, edhe pse meshkujt janë më pak të gatshëm të hyjnë në sferat e 'grave', sepse ato mendohen më pak të rëndësishme dhe më pak prestigjioze). Mirëpo, sa i përket politikës, në fillim të shekullit XXI, situata është e njëjtë në tërë Evropën, me disa përjashtime – edhe pse përbëjnë gjysmën e popullatës, në politikë gratë janë shumë pak të përfaqësuara. Në pozitat e pushtetit, përkatësisht pozitat vendmarrëse numri i grave është akoma më i vogël.

Bindja se politika i përket sferës së 'burrave' ndikon në dy anë – në vetë gratë që mendojnë se nuk e kanë vendin në politikë, dhe për atë nuk mendojnë për angazhimin në politik, dhe në mjedisin që nuk i përkrahin gratë nëse ato vendosin të merren me politikë. Përveç kësaj, siç u cek më lart, meshkujt janë më pak të gatshëm të marrin obligime që tradicionalisht i përkasin grave, ashtu që gratë jo rrallë ngarkohen më barrë të dyfishtë – me punët jashtë shtëpisë dhe punët shtëpiake. Pra, edhe pse nuk mund të thuhet formalisht se janë të penguar të merren me politikë,

gratë prapë duhen të kalojnë shumë pengesa vetëm se si të vendosin të fillojnë karrierën në politikë.

Një nga mënyrat e tejkalimit të pabarazisë iniciale e cila ekziston në politikë është sistemi me kuota, përkatësisht përcaktimi i numrit minimal të grave në parlament, kuvend apo në listat zgjedhore (ligjet dallojnë prej shtetit në shtet). Edhe pse kuotat janë zgjidhje e përkohshme, të cilat nuk merren me shkaqet por sanimin e pasojave, edhe përkrah saj, me vet mundësimin e përfaqësimit më të madh të grave në politikë ndikon shumë fort në gratë tjera. Gjithashtu, kontribuon në atë që opinioni i gjerë ti shohë gratë si politikane të afta, sistemi i kuotave gjithashtu ndikon edhe në ndryshimin e qëndrimeve tradicionale për gratë.

Për momentin prezenca e grave në jetën politike, në Evropë, është mesatarisht e kënaqur. Vlerësohet se në parlamentet nacionale Evropiane, vetëm 24% të deputetëve i përbëjnë gratë.. ky numër është pak më i madh për vendet Nordike – mbi 40%². Që të arrihet edhe ky numër, shumë vende mbështeten në sistemin e kuotave.³

Përfaqësimi grave dhe meshkujve në Parlament dhe Qeveri të Republikës së Serbisë vitet 2002-2012.												
Viti	2002.		2004.		2006.		2007.		2008.		2012.	
Institucioni	Parlament	Qeveri	Parlament	Qeveri	Parlament	Qeveri	Parlament	Qeveri	Parlament	Qeveri	Parlament	Qeveri
Meshkuj	219	15	223	15	Trupi nga 2004.	15	199	19	199	20	167	14
Gra	31	4	27	2		1	51	4	51	4	83	5
% gratë	12.4	21	10.8	11.7		6.3	20.4	17.4	20.4	16.6	33.7	26.3

Tabela 1. Të dhënat e marra nga publikimi *Gratë dhe Burrat* në Serbi⁴ dhe nga ueb faqja e Kuvendit Popullor të RS⁵

Legjislacioni dhe zgjidhja e imponuar "nga lartë" mund të ndihmojë për të gjetur zgjidhjen, dhe mund të përshpejtojë ardhjen deri te zgjidhja, por sa i përket angazhimit politik të grave, shumica e punëve duhet të kryhet në nivele të ulëta. Vetë partitë politike duhet të punojnë për fuqizimin e grave dhe inkurajimin e tyre që ato të përfshihen në politikë, fillimisht si anëtare, dhe pastaj të zhvillojnë nxitjen e masave ashtu që gratë të arrijnë në pozita udhëheqëse në parti. Pjesëmarrja më e madhe e grave në partitë politike nuk është vetëm e dobishme për fuqizimin e grave dhe avancimin e emancipimit të gruas, ajo lejon edhe funksionimin më të mirë të partive politike.

² Women in European politics – time for action, European Commission Directorate-General for Employment, Social Affairs and Equal Opportunities Unit G1 Manuscript completed in January 2009

³ <http://www.europarl.europa.eu/document/activities/cont/200903/20090310ATT51390/20090310ATT51390EN.pdf> faqes bashkëngjitur 10.09.2012.

⁴RZS Beograd 2008

⁵Kuvendi Popullor RS, www.parlament.gov.rs

REZULTATET E HULUMTIMIT

Hulumtimi mbi pjesëmarrjen e grave në partitë politike u zhvillua në korrik-gusht të vitit 2012. Nëpërmjet hulumtimit janë mbledhur tre lloje të të dhënave që na jep pasqyrë në karakteristikat themelore dhe trendet e pjesëmarrjes së grave në partitë politike në komunat e Bella Pallankës, Bujanocit, Dimitrovgradit, Pirotit dhe Preshevës. Të dhënat e mbledhura në lidhje me:

1. Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje në nivel lokal. Këto të dhëna janë mbledhur me ndihmën e pyetësorit që u zhvillua bazuar në metodologjinë e propozuar në publikim *Gratë dhe vendimmarrja në nivel lokal me metodologjinë e propozuar për monitorimin*.⁶
2. Pjesëmarrja e grave në partitë politike. Ky grup i të dhënave është mbledhur nëpërmjet pyetësorëve të mbushur nga 23 organizata politike, përkatësisht 17 partive politike dhe 6 grupeve të qytetarëve⁷. Bëhet fjalë për grupet politike të përfaqësuara në parlamentin lokal, në mënyrë që ata janë në gjendje të drejtpërdrejt për të krijuar një politikë lokale. Të dhënat e mbledhura në pyetësor kanë të bëjnë me të dhënat e përgjithshme me theks të veçantë në pjesëmarrjen e grave në aktivitetet e kryera gjatë vitit dhe pjesëmarrjen e tyre në punën e resorëve dhe këshillave përkatëse. Përveç kësaj, një pyetësor është përdorur për të shqyrtuar funksionet partiake të mbajtura nga gratë, dhe për të hetuar aktivitetet e partive që kryejnë në lidhje me të ashtuquajturat çështjet e grave.
3. Pikëpamjet e grave në pozicionin e tyre brenda partisë, përkatësisht në skenën politike lokale. Për këto tema u diskutua në grupet e fokusit me gratë që marrin pjesë aktive në punën e partive politike në pesë komunat e synuara. Ato në fokus grupet kanë vlerësuar mundësitë e grave për t'u angazhuar në politikë në mjedisin lokal, sidomos duke pasur parasysh marrëdhëniet e ambientit ndaj grave në politikë dhe roli i familjes. Përveç kësaj janë shqyrtuar mundësitë për gratë për të marrë pjesë në punën e organeve të partisë, progresi në shkallën politike dhe për të ndikuar në politikën partiake. Në hapin

⁶ Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale - Drejtoria për Barazi Gjinore, prill 2012.

⁷ Gjatë paraqitjes së rezultateve të kërkimit, termat - organizata politike, partitë dhe parti, kemi shfrytëzuar njëkohësisht edhe partitë e regjistruara politike dhe grupet qytetare që morën pjesë në studim

e ardhshëm të fokus grupeve është diskutuar për programeq që i zbatojnë partitë në lidhje me fuqizimin e grave në politikë, barazinë gjinore dhe zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Përparimin e Grave dhe Barazisë Gjinore. Së fundi, subjektet përmes sistemit koordinativ të "veprimit shoqërorë të sferave meshkuj dhe femra" është skicuar përfaqësimi i grave në pozita të pushtetit dhe pozita në vendimmarrëse. Këtu ato kanë skicuar më parë situatën aktuale në komunën e tyre, dhe pastaj kanë projektuar gjendjen synuese, përkatësisht për të cilën ato angazhohen përmes veprimtarisë së tyre politike.

Rezultatet e hulumtimit janë paraqitur së pari për secilën komunë, dhe pastaj janë dhënë konkluzione të përgjithshme. Rezultatet e studimit për secilën prej komunave janë paraqitur në mënyrë tendencioze sipas metodës me të cilin është marrë. Në këtë ne kemi qenë të udhëhequr nga ideja se këto ishin të dhëna heterogjene nga të cilat do të humbte gjendja e vërtetë se si partitë e shohin veten (të pyeturit), dhe nga ana tjetër si gratë e perceptojnë gjendjen e tyre brenda partisë, apo në skenën politike lokale (fokus grupet).

Bella Pallanka

Komuna e Bela Pallankës gjendet në pjesën juglindore të Serbisë, dhe i takon rrethit administrativ të Pirotit .Komuna mbulon një sipërfaqe prej 517 km², sipas regjistrimit të 2002. në të jetojnë 14.381 banorë, nga të cilët 7092 janë gra dhe burra 7289. Ashtu si shumë komuna të pazhvilluara në Serbi, Bella Pallankë përballet me rënie të përhershme të popullsisë. Sipas rezultateve paraprake të regjistrimit të vitit 2011 numri i banorëve të Bella Pallankës në krahasim me vitin 2002 ka rënë me më shumë se 15%. Bella Pallankë është një nga komunat më të pazhvilluara në Serbi. Shkalla e papunësisë në këtë komunë është 41.2%⁸, ndërsa të ardhurat mesatare në Bella Pallankë është rreth 55% e pagës mesatare neto në Serbi.

Përfaqësimi i grave dhe burrave në pozitat e vendimarrëse	Kryetari/ja komunës	Zëvendisi/ja kryetari/ja komunës	Këshilli komunal	Kryetari/ja kuvendit komunal	Nënkryetari/ja kuvendit komunal	Këshilltarë/et e kuvendit komunal	Kryetarët e grupeve të këshilltarëve
Femrat	0	0	2	0	0	10	0
Meshkujt	1	1	7	1	1	19	5

Tabela 2. Të dhënat korrespondojnë me situatën në gusht 2012.

Të dhënat e paraqitura në tabelën 2 tregojnë qartë dominimin e rëndësishëm të burrave në pozitat udhëheqëse në komunën e Bella Pallankë. Në fakt, pavarësisht nga numrat pothuajse të barabarta të burrave dhe grave të popullsisë së përgjithshme të komunës, pozicionet e vendimmarrjes janë të rezervuara për meshkuj. Gratë janë të përfaqësuara në nivelin e një të tretave të përcaktuara me ligj të vendeve në kuvendin komunal dhe në këshillin komunal, por jo në funksionet më të larta komunale. Ndikim të rëndësishëm në këtë gjendje të punëve është sigurisht në marrëdhëniet që kultivojnë partitë politike në pjesëmarrjen aktive të grave në politikë. Në një sondazh të kryer nga ne për këtë temë në komunën e Bella Pallankës kanë marrë pjesë tri parti politike dhe një grup i qytetarëve që janë të përfaqësuara në asamblenë lokale⁹.

⁸ SIEPA – Agjensioni për investime të huaja dhe promovimi i eksportit <http://serbia-locations.rs/municipalities-srb/>

⁹ SPS, GG za B. Palanku, DS i SNS

Pyetësor për pjesëmarrjen e grave në partitë politike

Bazuar në analizën e pyetësorëve, mund të themi se aktivistët e partive politike në Bella Pallankë janë të papunë të moshës mes 26 dhe 65 vjet. Partitë ndryshe kanë vlerësuar pjesëmarrjen e grave në anëtarësimin e përgjithshëm, kështu që disa thonë se kjo shifër është rreth 50%¹⁰, ndërsa për të tjerët nuk kalon 30%¹¹. Pavarësisht nëse ato janë gra apo burra, partitë vlerësojnë se vetëm rreth 30% të totalit të anëtarësitit merr pjesë aktive në të gjitha aktivitetet e organizuara gjatë vitit. Partitë që morën pjesë në këtë studim kanë qenë të ndryshme në madhësi dhe strukturë organizative, në mënyrë që numri i komisioneve përkatëse / këshillave brenda tyre është shumë i ndryshëm. Megjithatë, pavarësisht nga ky diversitet, analiza e pyetësorëve tregoi se gratë, pavarësisht nga opsionet politike të cilat ato i përkasin, më shumë janë të përfshira në punën e departamenteve të përfshira në zonat tradicionalisht femërore - fëmijët dhe të rinjtë, shëndetësia, mbrojtjes sociale. Sigurisht, ato ishin aktive në fusha të tjera, por me vlerësimin e partive në një masë më të vogël. Hulumtimi ka treguar se femrat janë dukshëm më të rralla se burrat në pozicione drejtuese në komisionet përkatëse dhe këshilla, kurse brenda strukturës partiake ato përparojnë më së shumti deri në funksionin e nënkryetares. Partitë në Bella Pallankë nuk kanë zhvilluar programe specifike që kanë të bëjnë me fuqizimin e grave, e programe të tilla nuk funksionojnë në fusha të tjera më të gjera. Sipas të dhënave të ofruara nga partitë gjatë këtij hulumtimi, në strukturën e tyre organizative nuk funksionon Forumi gruas apo organe të tjera të ngjashme ku fokusi do të ishte në të ashtuquajtura çështje grash.

Fokus grupet

Në fokus grupet në Bella Pallankë të anketuarat më parë diskutuan deklaratën "Meshkujt janë më të aftë për tu marrë me politikë sesa gratë." Përkatësia vijave të ndryshme politike këtu nuk ishte pengesë që të intervistuarat të pranojnë se deklarata e mësipërme nuk është e vërtetë. Megjithatë, ata besojnë se njerëzit janë të bindur se politika është puna e një mashkulli dhe se ato janë më pak të afta për

¹⁰ SPS

¹¹ GG Jedinstvo, DS, SNS

veprim politik kualitativ. Sipas tyre, ky qëndrim është më tepër një çështje e trashëgimisë dhe ndarjes tradicionale e punëve të grave janë të lidhura kryesisht me shtëpinë dhe familjen, dhe puna e meshkujve që ndër të tjera, nënkuptojnë karrierën dhe funksionet publike. Pretendimi se politika dhe veprimi publik nuk duhet të jenë të rezervuar vetëm për meshkuj, përveç një arsimimi të barabartë dhe përvojës në të njëjtën punë, të anketuarat përmendën si "përvoja e grave" e tyre si një avantazh në krahasim me burrat. Përvoja e grave për kujdesin në aspekte të ndryshme të funksionimit të familjes, sipas mendimit të tyre, mund të jetë shumë e dobishme në menaxhimin e burimeve publike dhe bashkësinë lokale.

Kur është fjala për mundësitë për t'u angazhuar në politikë dhe marrëdhënia e komunitetit për gratë në politikë, gratë theksuan se meshkujt janë ata të cilët kanë një pozitë më të mirë startuese dhe mundësi më të mëdha për veprim publik. Kjo është kryesisht për shkak të obligimeve që gratë kanë në shtëpi duke i lënë ato me më pak kohë për tu marrë me gjëra të tjera. Detyrimi i gruas është përkushtimi kryesisht në shtëpi dhe familje, pastaj punës dhe krejt në fund vjen politika apo ndonjë aktivitet tjetër. Duke pasur parasysh këto pritjet e grave, të intervistuarat mendojnë se komuniteti i tyre lokal nuk është terren i favorshëm për angazhimin e grave në politikë, sidomos jo për avancimin në shkallën e hierarkisë. Megjithatë, nga ana tjetër, të anketuarat besojnë se të thënat më lart nuk do të thotë se familja është një pengesë. Edhe kur meshkujt do të merrnin shumicën e obligimeve familjare, ato do të kishin nevojë që gjithë atë ta kontrollojnë. Prandaj, në qoftë se një grua vërtetë dëshiron që të përfshihet në politikë, ajo do të gjejë kohë për të.

Duke folur për pozitën e grave brenda partive të investuarat atë pozicioni e definojnë si "të nevojshme 30%." Konkretisht, sipas mendimit të tyre, meshkujt janë më të shumtë dhe më aktiv në jetën e partiake. Propozimet e grave shihen dhe pranohen në të njëjtën masë si propozimet e burrave, por janë ato që janë më pasive dhe ndërmarrin më pak iniciativa. Në skenën politike të Bella Pallankës nuk ka programe ndërpartiake për të mbështetur gratë në politikë, dhe ato janë të inkurajuar në politikë deri në atë masë që është e nevojshme për të plotësuar kuotën e femrave 30%. Kur është fjala për funksionet e partisë, veçanërisht ato që i përkasin meshkujve, kështu që mund të themi se janë absolutisht ata që krijojnë politikën partiake.

Barazia gjinore, diskriminimi, aftësitë politike, dhe çështje të tjera tash për tash nuk e kanë gjetur vendin e tyre në programet brenda fuqizimit të partisë në Bella Pallankë. Strategjia Kombëtare për Përparimin e Grave dhe Barazisë Gjinore sipas të

anketuarave është vetëm një koncept abstrakt me të cilën partitë në asnjë mënyrë nuk merren. Ato besojnë se puna për fuqizimin e grave në politikë është e nevojshme dhe se sa më shumë gra në vendimmarrje do të sjellë prosperitet për të gjithë. Duke analizuar përfaqësimin e burrave dhe grave në fusha të caktuara shoqërore, sidomos duke shikuar në pozicionet e vendimmarrjes, të anketuarat thanë se situata në Bella Pallankë është në vijën e ndarjes tradicionale në resorë të burrave dhe resorë të grave. Pra, mbrojtja sociale, përkujdesi për fëmijët dhe arsimit janë resorë në të cilat gratë luajnë një rol të rëndësishëm. Sipas pikëpamjes së tyre, një ndarje e tillë nuk duhet të ekzistojë, dhe ndarjet puna grash apo burrash duhet të lihet të shkuarës.

Bujanoci

Komuna e Bujanoci e vendosur në jug të Serbisë, dhe i takon rrethit administrativ të Pçinjës. Sipërfaqja e përgjithshme e komunës është 461 km², dhe territori i saj sipas regjistrimit të vitit 2002. jetojnë 43.302 banorë, nga të cilat 21.595 gra dhe 21.707 burra. Rreth 55% e popullsisë së komunës së Bujanocit janë shqiptarë, që komunën e bën një nga qendrat e komunitetit shqiptar në Serbi. Komuna e Bujanocit është një nga 46 komunat e pazhvilluara në Serbi, me një normë papunësie prej 34,11%¹².

Përfaqësimi i grave dhe burrave në pozitat e vendimmarrëse	Kryetari/ja komunës	Zëvendësi/ja kryetari/ja komunës	Këshilli komunal	Kryetari/ja kuvendit komunal	Nënkryetari/ja kuvendit komunal	Këshilltarë/et e kuvendit komunal	Kryetarët e grupeve të këshilltarëve
Femrat	0	0	0	0	0	13	/
Meshkujt	1	1	11	1	2	28	/

Tabela 3. Të dhënat korrespondojnë me situatën në gusht 2012.

Sipas të dhënave nga Raporti për përfaqësimin e grave në sektorin publik në Serbinë jugore dhe jugperëndimore¹³ mars të vitit 2011, gratë në komunën e Bujanocit janë të përfaqësuara në organet e vetëqeverisjes lokale me 17,72%¹⁴, ndërsa në pozita udhëheqëse në institucionet lokale, shërbimet publike dhe publik komunale nuk ka. Siç mund ta shikoni nga grafiku se situata pas zgjedhjeve në maj 2012. nuk është ndryshuar në mënyrë të konsiderueshme. Gra në funksionet më të rëndësishme të komunës nuk ka, kurse në kuvendin komunal zënë një të tretën e numrit të përgjithshëm të vendeve.

¹² USAID Projekt i zhvillimit të qëndrueshëm local
http://www.lokalnirazvoj.rs/assets/files/mapa_doc/IMCA%20VR%20One%20Pager%20SRB,%20June%202012%20final.pdf

¹³ Huluntimi është kryer në kuadër të Partneritetit Evropian me Komunat - BE www.euprogress.org Progres.

¹⁴ Përqindja referohet për përfaqësimin e grave në organe dhe trupat organeve të qeverisjes lokale, si kuvendet komunale, komisionet parlamentare, këshillave parlamentare, këshillat komunale, shef i administratës ose shërbime, zëvendës-shefi ose asistent dhe kryesuesit e divizioneve apo departamenteve

Në komunën e Bujanocit, në studimin janë përfshirë pesë parti politike dhe një grup i qytetarëve¹⁵. Si në komunat tjera, partitë kanë plotësuar pyetësorin për pjesëmarrjen e grave në partitë politike, kurse aktivistët e tyre morën pjesë në grupin e fokusit.

Pyetësor për pjesëmarrjen e grave në partitë politike

Sipas të intervistuarave që kanë plotësuar të intervistuarat e partive politike, aktivisti mesatar partiak në komunën e Bujanocit është personi i papunë i moshës ekonomikisht aktive. Nga anëtarësimi i përgjithshëm në partitë politike vetëm rreth 30% janë femra. Kjo përqindje e grave në punën e partive është e njëjtë kur bëhet fjalë për anëtarësimin e rregullt aktiv, e cila sipas vlerësimeve të partisë sillet rreth 50%.

Numri i këshillit përkatës përkatësisht këshillave brenda partisë ndryshon, por sipas të dhënave të mbledhura në pothuajse të gjitha partitë e anketuara më aktive në organet brenda-partiake që merren me problemet e fëmijëve dhe të rinjve, kulturës, shëndetësisë dhe mirëqenies. Megjithëse aktive në fusha të tjera, kontributi i grave është i njohur kryesisht në fushat tradicionalisht femërore. Kjo tendencë është e pranishme edhe kur flasim për gratë në pozita udhëheqëse në parti. Ato rrallë arrijnë pozitat e larta, përkatësisht në shkallën brenda partisë rritet deri në pozitën e zëvendës-presidentes, dhe nëse janë në krye të një departamenti zakonisht është Forumi i Gruas ose një nga ato fusha tradicionalisht femërore.

Kur është fjala për programe që merren me zhvillimin e kapaciteteve të grave në politikë apo barazinë gjinore, studimi tregoi se partitë në Bujanoc programe të tilla nuk zhvillojnë, por merren me këto çështje në kontekstin më të gjerë të fushave të tjera. Mbetet e paqartë se cilat janë ato programe, cilat janë qëllimet e tyre dhe në çfarë relacioni janë me Forumin e Gruas të cilat operojnë brenda tyre.

Fokus grupet

Aktivistet e partive politike që morën pjesë në grupin e fokusit në Bujanoc u pajtuan se politika në mjedisin e tyre është e rezervuar kryesisht për meshkujt. Sipas pikëpamjes së tyre, kjo gjendje e punëve nuk është një pasqyrë e aftësisë më të madhe të meshkujve për t'u marrë me politikë, por është shkaktuar nga ndarja tradicionale mes punëve meshkujsh dhe femrash. Të anketuarat shprehën qëndrimin

¹⁵PD Mr. Nagip Arifi, SNS, URS, GG dr.Arsiq, PVD i PDP

se femrat janë po aq të afta në politikë, që kontributi i tyre është i madh në politikë dhe mund të jetë edhe më i lartë.

Edhe pse mendojnë se familja dhe obligimet familjare nuk janë pengesë për tu marrë me politikë, dhe se mund të arrihet çdo gjë në qoftë se ju doni vërtetë, gratë shohin se burrat kanë mundësi më të madhe për tu marrë me politikë mu në faktin se ata janë pak ose aspak të përfshirë në punët e shtëpisë. Mjedisin lokal të anketuarat e vlerësuan si ambient të pafavorshëm për tu marrë gratë me politikë me komentin e Bujanocit se "për gratë asgjë nuk është e lehtë."

Kur bëhet fjalë për bazën e partisë, apo anëtarësisë së partive, gratë dhe burrat janë të përfaqësuara në nivel pothuajse të njëjtë. Palët janë të hapur për propozimet e grave dhe ato sipas mendimit të anketuarave shumë rrallë votohen. Megjithatë, progresi në kuadër të partisë dhe pozicionimet në funksionet partiake janë të rezervuara për meshkujt, ashtu që në fund të fundit janë ata që marrin vendime dhe që krijojnë politikën partiake.

Partitë politike në Bujanoc nuk kanë zhvilluar programe të veçanta që synojnë përfshirjen më të madhe të grave në politikë, përkatësisht fuqizimin e grave që janë të përfshira në jetën politike. Në fakt, ato nuk janë të njohura si grupe synuese të veçanta ndër-partiake e për të cilën do të duhej të punohej për fuqizimin politik të tyre. Forumet e grave që funksionojnë brenda partisë janë fokusuar në aktivitetet socio-humanitare dhe programeve që kanë të bëjnë me shëndetin e grave. Strategjia kombëtare për avancimin e pozitës së grave dhe barazia gjinore nuk ka qenë një temë që është diskutuar në kuadër të Forumit të grave dhe të partisë në përgjithësi.

Duke analizuar pozicionet e vendimmarrjes në komunën e Bujanocit, të anketuarat konfirmuan faktin e përmendur më lart se meshkujt janë ata që qeverisin me këtë komunë. Sipas mendimit të tyre do të ishte ideale që femrat menaxhojnë fusha si shëndetësia, mirëqenia sociale, arsimi, kujdesi ndaj fëmijëve dhe familjes, dhe kultura. Siç mund të shihni ato kanë zgjedhur kryesisht fushën tradicionale të grave, e cila është ndoshta për shkak të faktit se aktualisht nuk kanë asnjë fuqi vendimmarrëse as në këtë segment të veprimit shoqëror, dhe e cila "nga natyra" duhet të jetë në duart e tyre. Përveç kësaj, të anketuarat treguan se do të jetë me rëndësi të madhe që edhe gratë të kanë më shumë kontroll mbi financat publike. Nga njëra anë kjo do të çojë në menaxhimin më të mirë të fondeve të qytetarëve, dhe në anën tjetër ajo praktikë do të jetë një sinjal për gratë që paratë dhe financat janë edhe çështje e tyre. Në fund, një praktikë e tillë do të motivojnë gratë të jenë financiarisht të pavarur, si parakusht për emancipimin e tyre.

Dimitrovgradi

Komuna Dimitrovgradit ndodhet në pjesën juglindore të Serbisë dhe është një nga katër komunat e rrethit të Pirotit. Kjo është një komunë kufitare që mbulon një sipërfaqe prej 483 km² përgjatë kufirit me Bullgarinë. Sipas regjistrimit të vitit 2002. në komunën e Dimitrovgradit jetojnë 11.748 banorë, nga të cilat 5904 burra dhe 5844 gra. Për dekada me radhë, komuna përballlet me një rënie të përhershme të popullatës, ashtu që në Dimitrovgrad tani jeton gjysma e popullsisë se sa kanë jetuar në periudhën pas Luftës së Dytë Botërore, në bazë të rezultateve preliminare të regjistrimit të vitit 2011, popullsia ka rënë me 10% në krahasim me regjistrimin e mëparshëm. Pothuajse 50% e komunës së Dimitrovgradit janë anëtarë të komunitetit bullgar etnik, e që e bën komunën një nga qendrat pakicës kombëtare bullgare në Serbi. Shkalla e papunësisë në këtë komunë është 28,6%¹⁶, ndërsa banorët e Dimitrovgradit fitojnë vetëm rreth 55% të neto pagës mesatare në Republikën e Serbisë.

Përfaqësimi i grave dhe burrave në pozitat e vendimmarrëse	Kryetari/ja komunës	Zëvendësi/ja kryetari/ja komunës	Këshilli komunal	Kryetari/ja kuvendit komunal	Nënkryetari/ja kuvendit komunal	Këshilltarë/et e kuvendit komunal	Kryetarët e grupeve të këshilltarëve
Femrat	0	0	1	0	0	10	0
Meshkujt	1	1	6	1	1	19	2

Tabela 4. Të dhënat korrespondojnë me situatën në gusht të vitit 2012.

Siç kemi theksuar tashmë, pjesëmarrja e burrave dhe grave në tërë popullsinë e përgjithshme të komunës së Dimitrovgradit është e barabartë. Megjithatë, një shikim në tabelë tregon qartë një përfaqësim shumë më të ulët të grave në pozicionet e vendimmarrjes. Nga kjo shihet qartë se partitë politike janë kujdesur për përmbushjen kuotave, kështu që numri i këshilltareve në parlamentin lokal është 30%, në nivelin që përcaktohet me ligj. Megjithatë, me ngjitjen në shkallët hierarkike të komunës dhe duke shikuar funksionet ku krijohet politika komunale, veçanërisht

¹⁶SIEPA – Agjensioni për investime të huaja dhe promovimi i eksportit <http://serbia-locations.rs/municipalities-srb/>

kryetari, këshilli komunal dhe kryetari i kuvendit komunal, tregon një dominim të konsiderueshme të meshkujve. Në një situatë e tillë padyshim ndikojnë shumë faktorë, por kjo nuk mund të jetë shtyrë mënjanë fakti se partitë politike janë ato që me diskutimet e tyre të brendshme dhe negociatat me partnerët politikë të krijojnë mjedis politik.

Pyetësor për pjesëmarrjen e grave në partitë politike

Pyetësori mbi pjesëmarrjen e grave në punën e tyre i kanë plotësuar tri parti politike, si dhe një grup i qytetarëve të cilët në Kuvendin komunal të Dimitrovgradit¹⁷ përfaqësohen me 13 këshilltarë dhe 6 këshilltare. Bëhet fjalë për organizata politike me madhësi dhe ndikime të ndryshme, e që përfaqësojnë edhe pjesën e pushtetit edhe pjesën e opozitës. Sipas tyre, aktivisti mesatar i partive politike në Dimitrovgrad ka mes 26 dhe 65 vjeç dhe është i punësuar. Numri i grave që marrin pjesë në punën e partive politike vlerësohet ndryshe ashtu që sipas disave është rreth 50%¹⁸, ndërsa nga disa të tjerë nuk kalon 30%¹⁹ e numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Partitë politike besojnë që të paktën gjysma e anëtarëve të tyre është aktive në të gjitha aktivitetet që janë organizuar gjatë vitit, kurse gratë marrin pjesë në to në proporcion të njëjtë në të cilën ato janë aktive në aktivitetet e përgjithshme të partisë.

Numri i komisioneve përkatëse / këshillave në parti ndryshon, por të gjithë, pavarësisht nga opsionet e tyre politike, e kanë të përbashkët se gratë janë më aktive në zonat tradicionalisht "femërore" siç janë familja, arsimi, shëndetësia, mirëqenia sociale, kujdesin e fëmijëve dhe kultura. Nga ana tjetër, aktiviteti i rëndësishëm i grave në sektorë të tjerë të tilla si ekonomia, shërbimet publike, bujqësi dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor ndryshon nga partia në parti. Pavarësisht nga numri i funksionimit përkatëse të Këshillit / Bordi brenda partive politike, përqindja e grave që drejtojnë ato nuk kalon 30%. Pozitat partiake kryesore në Dimitrovgrad, përsëri pavarësisht nga opsioni politik janë të rezervuara për meshkujt. Sipas rezultateve të këtij studimi, gratë në këshillat lokalë të partive të veta, përveç në menaxhimin e komisioneve përkatëse / këshillave, avancojnë më së shumti deri në pozitën e zëvendës-kryetares.

¹⁷GG Drejtësia dhe Solidariteti, DS, SPS i SNS

¹⁸Partia demokratike

¹⁹Partia Socialiste e Serbisë, Partia Progresiste Serbe

Kur është fjala për programe që merren me fuqizimin e grave, partitë e anketuara kanë deklaruar se në kuadër të organizatave të tyre programe zhvillohen dhe zbatohen, por ato nuk janë të përcaktuara në mënyrë specifike, por janë pjesë e zonave të tjera të mëdha. Mbetet e pa-definuar se çfarë programe janë ata, si ndikuan ata në rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe përmirësimin e pozicioneve të tyre të përgjithshme në bashkësi, si dhe çfarë lidhje janë me aktivitetet e Forumit të Gruas, të cilat veprojnë në kuadër të partisë.

Fokus grupet

Si në komunat tjera, grupa e fokusit në Dimitrovgrad i ka mbledhur përfaqësueset e partive politike lokale aktive. Edhe këtu doli se çështja e gruas në politikë që shkon përtej dallimeve programore, dhe se qëndrimi ndaj këtij problemi nuk varet nga opsioni politik. Të intervistuarat ishin unanim në mendimin se gratë janë po aq të aftë për tu marrë me politikë, por angazhimet e tjera, veçanërisht ato në shtëpi, janë pengesë për tju përkushtuar më shumë politikës. Sipas mendimit të tyre, mu ky angazhim dhe kujdesi për familjen dhe punët e shtëpisë i mundëson burrave pozitë shartuese më të mirë për veprim në sferën publike. Mbështetja e familjes për burrin nënkuptohet, ndërsa mbështetja për gratë që merren me çështjet publike, jo rrallë u mohohet. Megjithatë, asnjë nga të anketuarat nuk e konsiderojnë familjen dhe obligimet familjare pengesë në politikë, por janë me thënien “gjendet koha për të gjitha”. Kur është në pyetje bashkësia lokale të intervistuarat mendojnë se sjellja e mjedisit ndaj grave në politikë është neutrale, dhe se ato nuk përballen me pengesa të veçanta me marrjen me politikë, por as në mbështetje.

Duke folur për situatën brenda partive, të anketuarat u pajtuan se meshkujt ishin në numër më të shumtë dhe më aktiv në partitë politike. Pa marrë parasysh atë që janë pakicë në nivelin e anëtarësisë, gratë brenda partisë ndjehen plotësisht të barabarta, e pikëpamjet e tyre, mendimet dhe sugjerimet janë perceptuar në të njëjtën mënyrë si ato të burrave. Megjithatë, pozicioni i funksioneve brenda partisë, sipas grave, i takojnë burrave, e ato janë aty kryesisht për të plotësuar formën dhe për të përmbushur kuotat. Kur vjen puna për të mbështetur partitë e tyre m pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë, gratë aktiviste që kanë marrë pjesë në grupin e fokusit ranë dakord se ajo ekziston, por nuk kanë përcaktuar se prej çka përbëhet mbështetja nga dhe si manifestohet.

Duke analizuar punën e Forumit të grave që veprojnë në kuadër të partisë, të anketuarat kanë treguar orientimin e këtij organi kryesisht për aktivitete socio-humanitare. Tema të tilla si barazia gjinore, pjesëmarrja e grave në politikë, aftësitë politike dhe të tjera, njihen si të rëndësishme, por deri tani ato nuk kanë qenë të trajtuara në Forum. Një nga pengesat më të mëdha për punë më të mirë në Forumin e Gruas, është mungesa e fondeve. Megjithatë, është e paqartë nëse shuma më e madhe e burimeve do të thotë më shumë aktivitete sociale dhe humanitare ose do të ndikojnë në funksionimin në drejtim të fuqizimit e aktivizimit politik të grave.

Në fund, duke skicuar përfaqësimin e grave në fusha të ndryshme të aktiviteteve shoqërore, duke pasur parasysh qëndrimin e pushtetit apo të pozitës në të cilën merren vendimet, të anketuarat kanë theksuar se meshkujt janë ata që sundojnë komunën e Dimitrovgradit, dhe se gratë janë më të pranishme në fusha tradicionalisht femërore. Sipas pikëpamjes së tyre, arsyet e vërteta për këtë gjendje të punëve nuk ekzistojnë; ndarja e pushtetit do të duhet të jetë e balancuar, përkatësisht nuk ka fusha shoqërore në të cilat meshkujve duhet ti jepet avantazh në krahasim me gratë.

Piroti

Piroti është qendra administrative e Qarkut të Pirotit, i cili përbëhet nga komunat Babushnica, Bella Pallanka dhe Dimitrovgradi. Komuna Pirot mbulon një sipërfaqe prej 1232 km² dhe si territor është një nga komunat më të mëdha në Serbi. Popullsia e përgjithshme e komunës sipas regjistrimit të vitit 2002. arriti në 63.791, prej të cilëve 31.790 femra dhe 32.001 meshkuj. Sipas rezultateve paraprake të regjistrimit të vitit 2011. popullsia e Pirotit ka rënë me rreth 10%. Popullsia në moshë pune në popullsinë totale të Pirotit është rreth 65% e të c papunë janë rreth 20%²⁰.

Përfaqësimi i grave dhe burrave në pozitat e vendimmarrëse	Kryetari/ja komunës	Zëvendësi/ja kryetari/ja komunës	Këshilli komunal	Kryetari/ja kuvendit komunal	Nënkryetari/ja kuvendit komunal	Këshilltarë/et e kuvendit komunal	Kryetarët e grupeve të këshilltarëve
Femrat	0	0	2	0	/	19	1
Meshkujt	1	1	5	1	/	37	2

Tabela 5. Të dhënat korrespondojnë me situatën në gusht 2012.

Në komunën e Pirotit, si dhe në komunat tjera në të cilat është kryer hulumtimi, pozitat e larta në qeverinë lokale mbahen nga meshkujt. Ata janë në pozitat e kryetarit të komunës dhe kryetarit të Kuvendit komunal, ndërsa gratë përbëjnë rreth një të tretën e mandateve në këshillin komunal dhe kuvendin komunal. Duhet të theksohet se gjendja e tanishme e gjërave, të paktën kur është fjala për Kuvend dhe në Këshillin komunal, ka një përmirësim me gjendjen e mëparshme. Kjo ishte kur këshilli komunal në Pirot ka pasur vetëm një anëtare e kuvendi komunal vetëm 25% të femrave, përkatësisht 14 këshilltare²¹.

Në studimin tonë në Pirot kanë marrë pjesë dy parti politike dhe dy grupe të qytetarëve²² që janë të përfaqësuara në parlamentin vendor me 11 këshilltare dhe 21 këshilltarë.

²⁰ Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Pirotit, prill 2009.

²¹ Gratë dhe vendimmarrja në nivel lokal dhe metodologjinë e propozuar për monitorimit

²² GG Koalicioni per Pirot, GG Lëvizja për Pirot, Partia Demokratike dhe Të Gjellbërit e Serbis

Pyetësor për pjesëmarrjen e grave në partitë politike

Anëtarët e partive politike në Pirot janë të moshës në mes 26 dhe 65 vjet, me status shumë të ndryshueshëm të punës²³. Sipas të pyetësorëve të plotësuar, gjysmën e anëtarësisë të partive politike²⁴ në Pirot e përbëjnë gratë. Ato përbëjnë gjysmën e anëtarësisë aktive të partive, ose anëtarëve të cilët në mënyrë aktive marrin pjesë në punën e partisë së tij dhe merr pjesë në shumicën e veprimeve që i realizojnë partitë gjatë vitit.

Kur flasim për Këshillave përkatëse dhe këshillat partiake në Pirot duhet të kemi parasysh se edhe këtu organizatat politike të anketuara janë shumë të ndryshme në madhësi dhe strukturën e brendshme. Kështu, dy grupet e qytetarëve që kanë marrë pjesë në hulumtim dhe që përbëjnë një segment shumë të rëndësishme të skenës politike në Pirot nuk kanë strukturë organizative që ne hasim në partitë politike klasike, dhe është një segment i tërë i pyetësorit mbi aktivitetet e grave në punën e komisioneve të ndryshme relevante dhe këshillave ka mbetur pa përgjigje. Situata është e ngjashme edhe me Partinë e Gjellbër. Të vetmet përgjigje në këtë pjesë të pyetësorit i kemi marrë nga Partia Demokratike dhe sipas tyre gratë janë më aktive në sektorët tradicionalisht femërore si kultura, shëndetësia, fëmijët dhe të rinjtë, dhe udhëheqin me vetëm tre prej pesëmbëdhjetë sektorëve. Përndryshe, ato në këshillin komunal të partisë kryejnë funksionet e Kryetares së Forumit të Grave, sekretare të këshillit komunal dhe kryetare të këshillit ekzekutiv.

Kur është çështja në fuqizimin e grave dhe zbatimin e programeve që merren me çështjet e barazisë gjinore, gratë në politikë etj, partitë e intervistuarat kanë theksuar se këto çështje nuk shihen të pavarura, por në kuadër të fushave tjera më të gjëra. Megjithatë, asnjë prej organizatave të anketuara nuk kanë raportuar rezultatet e këtyre programeve.

Fokus grupet

Biseda me aktivistet e partive politike dhe grupeve qytetare nga Piroti është kompensuar kryesisht me mungesën e disa përgjigjeve të disa pyetjeve nga pyetësi.

²³ Ndryshe nga partitë e anketuara në komunat tjera, që shumica e anëtarëve të tyre në mënyrë të qartë janë përcaktuar në " të punësuar" ose "të papunë", partitë politike në Pirot nuk ishin aq të theksuara, por theksuan pjesën e barabartë të papunëve, të punësuarve dhe bujqëve në anëtarësimin e saj.

²⁴ Sipas pyetësorëve të plotësuar, anëtarët aktivë të partive politike përbëjnë 30% të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Nëpërmjet grupeve të fokusit, të anketuarat kishin mundësinë për të hedhë dritë mbi statusin e grave dhe pjesëmarrjen e tyre në grupin e qytetarëve që janë të përfaqësuar në parlamentin lokal. Pavarësisht nga forma e organizimit politik dhe opsionit politik që i përkasin gratë në Pirot që zgjedhin të jenë të angazhuara në politikë përballen me të njëjtat sfida. Para së gjithash ajo është një trashëgimi që politika i përket meshkujve dhe se ata janë më të aftë për t'u marrë me të. Mjedisi pret që gratë të merren me shtëpinë dhe familjen, dhe të lënë politikën për meshkujt. Disa të anketuara theksuan edhe ndjenjën se gratë në politikë janë dekorim dhe mjedisi nuk është ende i gatshëm ta lërë në dorë të grave vendimmarrjen. Grupi u pajtua se kjo sjellje e mjedisit është paragjykim dhe se femrat janë po aq të afta si burrat, të kryejnë funksionet më të përgjegjshme në shoqëri. Përveç kësaj, mendimi se ndryshime të vogla kanë ndodhur, por ka shumë punë për të bërë që gratë në thelb të jenë të barabarta në jetën politike të Pirotit.

Kur është fjala për aktivitetet e grave në punët partiake, të anketuarat vlerësuar se numri i tyre është pothuajse aq sa edhe burrat, por ato janë shumë më pak aktive. Aktivitetet e grave në partitë nënkupton kryesisht punët e logjistikës dhe operacionet e mbështetjes, aktivizimi i tyre është i inkurajuar vetëm para zgjedhjeve, me qëllim të plotësimit kuotave. Funksionet partiake në Pirot kryesisht i kanë meshkujt, edhe pse ato janë formalisht të hapura edhe për gratë.

Temat që merren me problemet e grave dhe përmirësimin e pozitës së tyre si në parti apo në shoqëri nuk zënë një vend të rëndësishëm në agjendën politike të partive në Pirot. Strategjia kombëtare për avancimin e grave dhe barazisë gjinore në partitë politike gati as nuk ceket. Është interesante se disa nga të anketuarat ishin të njohura për ekzistencën e forumit të grave në partitë e tyre, por ato nuk kishin asnjë informacion në lidhje me aktivitetet e këtij organi.

Në fund, si në fokus grupet e tjera, të anketuarit përmes analizës së shkurtër të pozicioneve të vendimmarrjes në komunën e Pirotit erdhën në përfundimin se vendimet në këtë komunë i kanë kryesisht meshkujt. Sipas mendimit të tyre ndryshimi i kësaj situate është i domosdoshëm, e që kjo të ndodhë ajo duhet të punohet shumë në edukimin e politikanëve, politikanëve dhe të gjithë komunitetit për rëndësinë e pjesëmarrjes më të madhe të grave në vendimmarrje.

Presheva

Komuna e Preshevës është e vendosur në Serbinë jugore në afërsi të kufirit me Maqedoninë. Ajo mbulon një sipërfaqe prej 264 km² dhe është pjesë e Qarkut të Pçinjës. Sipas regjistrimit të vitit 2002 në Preshevë jetojnë 34.904 banorë, nga të cilët 50,26% janë femra. Gati 90% e popullsisë së Preshevës janë shqiptarë. Komuna e Preshevës bjen në një nga zonat e shkatërruara të Republikës së Serbisë, që nënkupton se niveli i zhvillimit të saj është nën mesataren republikane 50%. Sipas të dhënave në dispozicion, shkalla e papunësisë në këtë komunë është rreth 45%²⁵.

Përfaqësimi i grave dhe burrave në pozitat e vendimarrëse	Kryetari/ja komunës	Zëvendisi/ja kryetari/ja komunës	Këshilli komunal	Kryetari/ja kuvendit komunal	Nënkryetari/ja kuvendit komunal	Këshilltarë/et e kuvendit komunal	Kryetarët e grupeve të këshilltarëve
Femrat	0	0	0	0	0	11	0
Meshkujt	1	1	11	1	2	27	5

Tabela 6. Të dhënat korrespondojnë me situatën në gusht 2012.

Sic mund ta shikoni nga tabela, pas zgjedhjeve në maj të vitit 2012 në Preshevë në karriqat e kuvendit ulen 11 gra, në mënyrë që ato të formojnë pothuajse 29% të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve. Në këtë mënyrë, pjesëmarrja e tyre në punën e këtij organi është afër kuotës së përbalueshme. Megjithatë, është e qartë se kjo prire ka anashkaluar pozitat tjera në pushtetin lokal, kështu që në të gjitha vendet ku merren vendimet janë meshkujt. Për fat të keq, ky studim nuk është marrë me mbledhjen e të dhënave mbi përfaqësimin e grave në pozita udhëheqëse në institucionet lokale pas formimit të pushtetit të ri. Këto të dhëna janë sigurisht shumë të rëndësishme dhe kjo do të jetë e mirë për të krahasuar ato me situatën mars 2011. kur në krye të institucioneve lokale në Preshevë nuk ishte as një grua e vetme²⁶.

²⁵ USAID Projekt i zhvillimit të qëndrueshëm lokal

http://www.lokalnirazvoji.rs/assets/files/mapa_doc/IMCA%20VR%20One%20Pager%20SRB,%20June%202012%20final.pdf

²⁶ Raport mbi përfaqësimin e grave në sektorin publik në Serbinë jugore dhe jugperëndimore. Programi i Partneritetit Evropian me Komunitat - BE Progres www.euprogres.org

Në hulumtimin e bërë në Preshevë kanë marrë pjesë katër parti dhe një grup i qytetarëve²⁷, saktësisht, të gjitha organizatat politike që janë të përfaqësuara në Kuvendin Komunal.

Pyetësor për pjesëmarrjen e grave në partitë politike

Anëtarët e partive politike në Preshevë janë kryesisht njerëz të papunë të moshës mes 26 dhe 65 vjet. Sipas partive të anketuara vetëm një e treta e anëtarëve të tyre janë aktiv në shumicën e veprimeve që ata organizojnë gjatë vitit. Kur është fjala për gratë, ato në partitë politike në Preshevë përbëjnë më pak se 30% e anëtarësisë totale, përkatësisht anëtarësisë aktive.

Si edhe në komunat e tjera, pjesë e hulumtimit i cili u realizua në Preshevë ka përfshirë partitë politike me madhësi dhe strukturë të brendshme të ndryshme. Duke analizuar çështjet që lidhen me pjesëmarrjen e grave në punën e resorëve përkatëse dhe këshillave, edhe këtu mund të themi se gratë më aktive janë në fusha tradicionalisht femërore, veçanërisht kultura, arsimit dhe kujdesi i fëmijëve. Duke pasur parasysh pjesëmarrjen e ulët të grave në partitë politike në Preshevë nuk habit fakti që ato menaxhojnë me më pak se një e treta në kuadër të resorëve partiake. Duke parë funksionet tjera në parti, gratë po përparojnë deri në nivelin e nënkryetares ose zëvendëses, dhe natyrisht udhëheqin me Forumin e Gruas.

Roli i Forumit të grave në partitë politike dhe këtu mbeti i paqartë. Sipas të dhënave të mbledhura, partitë merren me çështjet e grave, por përmes programeve të tjera. Sipas mendimit të tyre, këto programe kanë kontribuar në avancimin e pozitës së grave. Ende ka mbetur e paqartë se çfarë lloji i përparimit është në pyetje, dhe cili është roli i Forumit të Grave në strukturën e tërë.

Fokus grupet

Qëndrimet e politikaneve, pjesëmarrëset e fokus grupeve në Preshevë për pozicionin e tyre brenda partisë, apo në skenën politike lokale, ishin pothuajse identike, pavarësisht nga opsionit politik që i takojnë. Së pari, mbizotëroi mendimi se gratë e kanë shumë më të vështirë që të pozicionohen në politikë, dhe se suksesi i tyre në këtë fushë është provë se ato janë po aq të afta sa burrat për politikë, por edhe më të afta, duke marrë parasysh pengesat që duhet të kalojnë. Pengesat që janë identifikuar më herët parandalojnë gratë që aktivisht të angazhohen të kyçen në politikë, para gjithash

²⁷ PVD, UDSH, GG Rilindia demokratike, BDL i PDSH

obligimet në shtëpi dhe qëndrimi tradicional i komunitetit ndaj politikës, si punë e meshkujve. Subjektet ranë dakord se gruaja është ajo që është përgjegjëse për shtëpinë dhe familjen dhe se për këtë arsye ajo ka pak kohë për tu marrë me politikë. Edhe pse të vetëdijshme se angazhimi në familje ia redukton mundësitë për tu marrë me politikë, qëndrimi i të anketuarave është se gjithçka mund të arrihet nëse vërtet dëshironi. Është interesante se të anketuarat theksuan bashkësinë e tyre lokale, si ambient shumë tradicional dhe mjedis të pafavorshëm për marrjen e grave me politikë. Megjithatë, nëse një grua merr guximin dhe fillon një karrierë politike, ajo hasë në respekt të sinqertë të bashkëqytetarëve.

Edhe pse në numër më të vogël, gratë në punën e partive politike janë aktivisht të barabarta si meshkujt. Ato marrin pjesë në punët e organeve të partisë dhe propozimet e tyre miratohen. Megjithatë, ato nuk janë në pozitë vendimmarrëse, ashtu që janë meshkujt ata që e bëjnë politikën e përgjithshme të partive në Preshevë, e si rrjedhojë e saj edhe politikën e përgjithshme lokale.

Të anketuarat theksuan se në partitë e tyre ekzistojnë Forumet e grave, por që ekzistenca e tyre është një shkronjë e vdekur në. Sipas pikëpamjes së tyre, partitë nuk zbatojnë programe që kanë të bëjnë me avancimin e pozitës së grave, qoftë në politikë, qoftë në shoqëri. Gratë janë pjesë e partisë vetëm para zgjedhjeve sa për të plotësuar kuotën prej 30%. Për të ilustruar, është theksuar fakti se çështjet e grave gjatë gjithë fushatës ishte temë e vetëm një emisioni televiziv. Gjatë fokus grupeve janë theksuar disa çështje që në të ardhmen do të duhet merren si brenda partisë ashtu edhe në tërë shoqërinë. Megjithatë, si çështja më e ngutshme është theksuar dhuna në familje. Sipas mendimit të të anketuarave, ky është një problem që do të duhet të jetë në krye të agjendës politike të secilës parti në Preshevë dhe që duhet të merren edhe meshkujt edhe gratë.

Duke analizuar pozicionet e vendimmarrjes në Preshevë, u vu në dukje se absolutisht të gjitha fushat e veprimit shoqëror janë në duart e meshkujve. Duke projektuar ndarjen e pozitive ku ato synojnë, të anketuarat kanë zgjedhur për rishpërndarjen tradicionale të resorëve mashkullore dhe femërore, duke justifikuar këtë nga fakti se gratë janë thjesht më të afta dhe në disa sfera, ose më të ndjeshme për disa tema të caktuara. Sidoqoftë, fokus grupi në Preshevë ofroi edhe një zgjidhje si produkt që nuk ndodhi në komunat tjera. Konkretisht, sipas mendimit të tyre, do të ishte shumë mirë nëse departamenti i sigurisë i takon grave. Kjo është kryesisht për shkak të problemit të përmendur më parë, dhunës në familje. Me grua në krye të strukturave të sigurisë, gratë do të gëzonin mbrojtje më të madhe, e që është hapi i parë në procesin e zgjidhjes sistematike të këtij problemi kompleksiv.

Konkluzionet e përgjithshme

Hulumtimi mbi pjesëmarrjen e grave në partitë politike u zhvillua në pesë komuna dhe ka përfshirë një total prej 23 organizatave politike të madhësive dhe profileve të ndryshme dhe parime programore. Përfundimi kryesor i këtij studimi është sigurisht fakti se konteksti lokal dhe bindjet politike nuk kanë pothuajse asnjë ndikim në pozitën e grave në partitë politike e as për pozicionimin e tyre në skenën politike lokale. Gratë në secilën prej komunave të synuara përballen me pothuajse të njëjtat probleme dhe sfida, të cilat në mënyra shumë të ndryshme ndikojnë, nga njëra anë në vendimin e tyre për tu kyçur në jetën politike të bashkësisë lokale, e në anën tjetër, sigurisht edhe në mundësinë e avancimit në shkallën e partisë dhe pushtetit politik. Konkluzionet e përgjithshme të këtij hulumtimi janë si më poshtë:

- Funkcionet më larta komunale - Kryetari dhe Kryetari i Komunave të Bella Pallankës, Bujanocit, Dimitrovgradit, Pirotit dhe Preshevës mbahen nga meshkujt.
- Sistemi i kuotës i cili ka siguruar grave një të tretën e vendeve në parlamentin lokal rezultoi si i suksesshëm për përfshirjen e grave në politikën lokale. Partitë e anketuara kryesisht i mbahen këtij vendimi, kështu që gratë përbëjnë një të tretën e të gjitha këshillave lokale në komunat e synuara.
- Gratë brenda partive janë më aktive në resorët e këshillave dhe këshillat që kanë të bëjnë me fusha tradicionalisht femërore siç janë: kujdesi për fëmijët dhe familjen, mirëqenia sociale, shëndetësia, arsimi dhe kultura.
- Gratë nuk kanë funksione të larta partiake. Ato përparojnë deri në pozitën e nënkryetares, zëvendëse, sekretare apo kryetare e ndonjë bordit apo këshillit.
- Anëtarët e partive politike mendojnë se gratë janë po aq të afta për tu angazhuar në politikë si edhe homologët e tyre meshkuj. Nga ana tjetër, mendojnë se homologët e tyre meshkuj e shohin veten si më të aftë, dhe me qëndrim të tillë ata krijojnë një mjedis në të cilin politika i takon kryesisht meshkujve.

- Partitë nuk inkurajojnë gratë për pjesëmarrje më të madhe në punën e tyre. Programe për fuqizimin e grave nuk ka, si për fuqizimin e grave në parti dhe jashtë partisë. Gratë janë të ftuara në partitë politike dhe postohen në listat zgjedhore vetëm për të përmbushur kuotën dhe për këtë arsye ato e ndjejnë përkrahjen e partive vetëm në fushatën parazgjedhore.
- "Përvoja e grave" mund të ndihmojë punën e partive politike. Gratë kanë një pasqyrë unike në fusha të caktuara të shoqërisë meqë gjatë pjesës më të madhe të jetës kujdesen për njerëzit e tjerë.
- Aktualisht shumica e sferave të veprimit shoqëror janë në duart e meshkujve. Femrat nganjëherë i lëshohen fushat tradicionalisht femërore - kultura, arsimit, kujdesi shëndetësor etj. Është interesante se shumica e anëtareve pajtohen me ndarjen tradicionale të zonës, duke besuar se gratë jo vetëm që janë më të kualifikuara për ato fusha, por janë më të ndjeshme ndaj problemeve që janë të përfshirë në këto fusha. Ka dy përjashtime: në disa grupe të fokusit është theksuar se financat duhet ti përkasin grave, e në një fokus grup është theksuar në veçanti se siguria duhet të gjendet në duart e grave. Arsyet për insistimin në këto fusha janë: financat në duart e grave do të mundësonin një shpërndarje të ndryshme të burimeve buxhetore dhe me këtë gratë mund të përmirësojnë pozitën e tyre; e arsyeja për insistimin mbi sigurinë është problemi i madh i dhunës në familje me të cilin përballen gratë në atë komunë, e nuk kanë kujt ti drejtohen. Mendohet se vetëm gratë mund të rregullojnë sigurinë ashtu që viktimave të dhunës në familje ti sigurohet dalje e sigurt nga situata e dhunës.
- Strategjia Kombëtare për përparimin e grave dhe barazisë gjinore, ose nuk përmendet, përkatësisht anëtarët e partisë nuk ishin në dijeni të kësaj, apo për atë strategji kanë dëgjuar nëpërmjet mediave. Programe të veçanta për përparimin e barazisë gjinore nuk ka.
- Forume të grave ekzistojnë ose vetëm 'në letër' ose merren kryesisht me aktivitete socio-humanitare.

REKOMANDIMET

Rezultatet e hulumtimit mbi pjesëmarrjen e grave në partitë politike padyshim tregojnë se politika lokale dhe politika e partive politike krijohet nga meshkujt. Përveç kësaj, u tregua, partia nuk i jep rëndësi çështjeve të tilla si barazia gjinore, përfshirjen e grave në aktivitetet e partive politike dhe fuqizimin e grave për tu marrë me politikë. Duke dëshiruar të inkurajojmë partitë politike që të marrin masa dhe të ndryshojnë këtë gjendje të gjërave, në këtë pjesë të publikimit do të paraqesim një sërë masash për pjesëmarrje më të madhe dhe më aktive të grave në partitë politike. Duhet të theksohet se këto masa nuk janë një garanci dhe recetë e suksesit, por definitivisht mund të ndihmojnë organizatat politike të përmirësojnë punën e tyre, të pozicionohen më mirë në skenën politike dhe të kontribuojnë në demokratizimin e përgjithshëm të shoqërisë.

Masat për pjesëmarrje më të madhe dhe më aktive të grave në partitë politike të prezantuara këtu janë të bazuara në një botim *Fuqizimi i grave për partitë më të fuqishme politike - Udhëzime për promovimin e pjesëmarrjes së grave në politikë*²⁸.

- Në dokumentet e brendshme të partive politike (statutet, rregulloret, etj.), si dhe në procedurat e tyre formale dhe joformale të përfshihet perspektiva gjinore. Në këtë mënyrë partia më parë tregon përkushtimin e saj ndaj parimeve demokratike moderne, atëherë i japin sinjal anëtarëve të vet se çështja e barazisë gjinore dhe roli i gruas në zhvillimin social është i një rëndësie vendimtare për ta, dhe në fund në mjedisin ku veprojnë të shfaqen me pozita të qarta në lidhje me statusin e grave. Duhet patjetër të theksohet se përfshirja e perspektivës gjinore në të gjitha dokumentet e partisë nuk mund të jetë formë, por një hap thelbësor drejt shoqërisë barabartë.
- Të miratohen masat që do të sigurojnë pjesëmarrjen e grave në organet qeverisëse, përkatësisht pozicionimin në vendet ku merren vendimet dhe krijohet politika partiake. Një nga mundësitë për një gjë të tillë është futja e kuotave të detyrueshme të brendshme për pjesëmarrjen e grave në të gjitha organet e menaxhimit të partisë dhe në të gjitha nivelet. Ne besojmë se partitë

²⁸ *Empowering Women for Stronger Political Parties - A Guidebook to Promote Women's Political Participation.* United Nations Development Program and National Democratic Institute for International Affairs

kuotën e tyre të brendshme mund ta përcaktojnë në nivelin minimal prej 40%. Kjo është për tri arsye. Së pari, kjo shifër pasqyron më mirë pjesëmarrjen e grave në punën e përgjithshme të partisë. Së dyti, partia krijon një mjedis më të favorshëm për marrjen e grave me politikë. Së treti, një numër më i madh i grave në funksionet partiake, krijon bazën më të madhe nga e cila është e mundur që të delegohen gratë për kryerjen e funksioneve publike. Kuotat e brendshme të përcaktuar, partitë duhet t'i përmbahen edhe kur i bëjnë listat dhe delegojnë anëtarët e saja në postet publike.

- Sistematikisht të merret me fuqizimin e grave në parti. Është shumë e rëndësishme që në fuqizimin e grave në parti, duhet punuar në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike. Programet e fuqizimit mund të përqendrohen në çështjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e tërësishëm të grave në bashkësi; pastaj në programet që kanë të bëjnë me përvetësimin dhe përmirësimin e aftësive të nevojshme për politikë; dhe në fund programet lidhur me menaxhimin dhe vendimmarrjen për politikanet që do të zënë, ose që i mbajnë postet publike apo partiake.
- Të krijohen dhe të fuqizohen forumet e grave apo forume të ngjashme brenda organeve të partisë. Përparim që mund të çojë në një pozitë më të mirë të grave në parti sigurisht që është transformimi i plotë i Forumit të Gruas dhe ripërcaktimin e qëllimit të tyre të ekzistimit dhe mënyra e funksionimit. Forume ekzistuese të grave zakonisht merren aktivitete periodike socio-humanitare. Në organizatat politike moderne të tilla organe brenda partisë kujdesen për perspektivë gjinore të politikave propozuese. Përveç kësaj, ato punojnë në promovimin e pjesëmarrjes më të madhe të grave në politikë dhe proceset vendimmarrëse; monitorojnë nëse sistemi i kuotave zbatohet siq është paraparë me dokumentet partiake; posaçërisht i drejtohen grave gjatë fushatës zgjedhore; punojnë në fuqizimin e politikanëve dhe politikaneve nëpërmjet realizimit të trajnimeve; etj . Duhet të theksohet se kryetarja i Forumit të Grave sipas rregulloreve të shumë partive në botë, automatikisht është anëtare i këshillit qendrorë të partisë. Mu ky model i Forumit të Grave, si organe që në mënyrë aktive marrin pjesë në aktivitetet e partive politike dhe

kujdeset kryesisht për interesat e grave, është modeli të cilin partitë politike në Serbi duhet të përpiqen.

- Të përfshihen meshkujt. Politika tradicionalisht shihet si një zonë që i përket meshkujve. Ndryshimet në këtë plan duhet të zbatohen në tërësi, por është e rëndësishme në tërë procesin edhe të përfshihen. Rekomandimi kryesor për partitë është që brenda strukturës së tyre rregullisht të zhvillohen aktivitete me të cilat do të ngritin njohuritë e meshkujve në lidhje me domosdoshmërinë e përfshirjes së grave në politikë dhe përfitimet që sjell ky proces. Këto aktivitete mund të nënkuptojnë trajnime, seminare, mini fushatat, etj.
- Të ndikohet në komunitet. Përmes politikës që udhëheqin partitë politike drejtpërdrejt të ndikojnë në jetën e komunitetit, pa marrë parasysh sa është e madhe apo e vogël. Me qasje aktive ndaj komunitetit, duke këmbëngulur mbi barazinë gjinore dhe të drejtat e grave, promovimin dhe pozicionimin e politikaneve në pozita përgjegjëse të partisë sigurisht se mund të krijohet një mjedis më i mirë për tu marrë me politikë gratë.



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

Centar za razvoj građanskog društva



Center for civil society development